



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

Komuna e Mitrovicës Jugore
Opstina J.Mitrovica – Municipality of S. Mitrovica



Drejtoria e Inspekcioneve

06.07.2026

RAPORTI I PUNËS I DREJTORISË SË INSPEKCIONIT

JANAR-QERSHOR
2026



Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Mitrovicës Jugore
Opstina J.Mitrovica – Municipality of S. Mitrovica



Drejtoria e Inspekcioni

REFERENCE	01-052/09-0041620/20 dt 17.07.2026
PËR/ZA/TO:	Z. Faton Peci – Kryetar i Komunës – Mitrovica e Jugut.
CC:	Z. Enis OSMANI, Nënkyetar i Komunës – Mitrovica e Jugut.
NGA/OD/FROM:	z. Mujë IGRISHTA – Drejtor i Drejtorisë së Inspekcioni, Komuna – Mitrovica e Jugut.
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Raporti i Punës së Drejtorisë së Inspekcioni për periudhën: Janar – Qershor 2026
DATA/DATUM/DATE:	06.07.2026

Raporti i punës së Drejtorisë së Inspekcioni, bazohet në kompetencat dhe përgjegjësit ligjore që dalin nga dispozitat ligjore si: Ligji nr. 03/L-40 për Vetëqeverisjen Lokale, Ligji nr. 08/L-067 për Inspektime, Ligji për Inspektoratin e Tregut 03/L-181, Ligjin 04/L-186 për Plotësim Ndryshimin e Ligjit 03/L-181, Ligji 04/L-175 për Inspektoratin e Ujrave, Natyrës, Planifikimit dhe të Ndërtimit, Ligjit nr. 04/L-179 Për Transportin Rrugor, Ligji nr. 04/l – 110 për ndërtim, Statutin e K.K. Mitrovicë e Jugut, Rregulloren nr. 02/2012 dhe nr. 01/2017 për Organizimin, Kompetencat dhe Përgjegjësitë e Organeve të Administratës Komunale dhe akte tjera ligjore.


I Nderuar Kryetar i Komunës së Mitrovicës Z. Faton Peci,

Bazuar në detyrat dhe përgjegjësit që derivojnë nga Vendimi me **Nr. 09-020/02-0002800/26 të dt.16.01.2026** të lëshuar nga ana e juaj me rastin e emërimit tim në pozitën e drejtorit të Drejtorisë së Inspekcioni Komunal të Mitrovicës së Jugut, si dhe duke u bazuar në detyrën e dhënë, në vazhdim gjeni të bashkangjitur Raportin e detajuar të punës për periudhën kohore nga data e emërimit tim në këtë pozitë e deri me sot.

Në kuadër të Drejtorisë së Inspekcioni Komunal të Mitrovicës së Jugut funksionojnë gjithësejt 4 Sektorë, Inspektorja e Ambientit dhe administrata, të cilat po i paraqesim me Organogram si në vijim:



KOMUNA E MITROVICËS
DREJTORIA E INSPEKSIONIT - ORGANOGRAMI



Konstatimi i Gjendjes së Drejtorisë;

Sektori i Ndërtimit, Sektori i Shërbimeve Publike dhe Mbrojtje të Mjedisit, Sektori për Transportin Rrugor, Sektori i mbikëqyrjes së tregut, si dhe Administrata.

Pas marrjes së detyrës zyrtare, kam zhvilluar takimin e parë përnjohës me stafin e zyrës së Inspektionit. Nga ky takim në mungesë të pranim – dorëzimit të detyrës zyrtare nga ish drejtori paraprak, kam filluar me ingjizimin e gjendjes faktike, me ç ‘rast kamë kërkuar nga shefat e dy sektorëve dhe nga inspektor të të dy sektorëve tjera (në mungesë të shefave të sektorëve) të më njoftojnë me raportet e punës, me plan programin e punës, si dhe me sfidat dhe ballafaqimet me të cilat po përballen si Drejtori.

Gjatë përnjohjes me gjendjen në këtë drejtori me sektorët si më lartë, kamë hasur në probleme që kanë të bëjnë me natyrën si në vijim;

- Mungesa e Vendimmarrjes;
- Dështim në planifikim të Buxhetit për nevojat dhe problematikat me të cilat ballafaqohet kjo Drejtori;
- Ndërhyrja e “Politikës Ditore” në Ekzekutimin e Vendimeve përfundimtare;
- Trajtim i rasteve në mënyrë Selektive;
- Uzurpim i Hapësirave Publike;
- Ndërtime pa Leje;
- Shfrytëzim i Lokaleve dhe Anekseve prona publike nga Individ të afërt me Politiken e kaluar drejtuese pa i kryer obligimet ndaj Institucionit të Komunës;
- Shkelje e së drejtës së pronësisë private nga persona të pa përgjegjshëm të afërt me Politiken;
- Mos lirim i Hapësirave Publike – Tregut;
- Mos marrja e masave ndëshkuese ndaj atyre që e ndotin ambientin;
- Mos marrja e masave ligjore që obligon drejtorit përgjegjës për largimin e mbeturinave në lumenjtë e qytetit, deponive ilegale dhe të tjerave;
- Shfrytëzim i Terasave prone komunale pa kryer obligimet financiare ndaj Komunës;
- Shfrytëzim i Panove (të gjitha kategoritë reklamuese) dhe Hapësirave Reklamuese duke mos kryer obligimet ndaj Komunës;

- Mos marrja e masave për lirim e hapësirave të uzurpuar publike – parkingjeve, të shfrytëzuara dhe uzurpuara si nga individ e po ashtu nga bizneset;
- Mos marrja e aksioneve në mbrojtje të Konsumatorit (në lidhje me lëshimin e kuponëve fiskal);
- Mos marrje e masave (organizim/bashkinspektim me Inspektoratin Sanitar) për shkelësit e ligjit që ndalon pirjen e duhanit në hapësirat publike;
- Mos marrje e masave ligjore ndaj Transportit Rrugor;
- Funksionimi i Taksive privat pa leje dhe mungesë e një regjistri të sakt me numrin e atyre që operojnë;
- Mos kontroll ndaj funksionimit të Radiotaksive dhe Rentave të cilat operojnë në qytet;
- Mungesa e kushteve të punës (Vetura Zyrtare, pajisje kompjuterike së bashku me elemente përcjellëse për natyrën e punës të cilën e mbulojnë kjo Drejtori.

VEPRIMET E NDËRMARRURA DHE ATYRE NË PROCESË;

Pas konstatimit të gjendjes ekzistuese në Drejtorinë e Inspekcionit, në këtë gjashtëmujorë të parë kamë ndërmarr të gjitha veprimet e duhura ligjore mbi bazën e mandatit, kompetencave dhe përgjegjësisë që me takojnë.

- Në mungesë të Inspektorit të Ambientit dhe mos planifikimit, nëpërmjet Prokurimit kemi kontraktuar shërbimet duke angazhuar Inspektorin për mbrojtjen e ambientit;
- Përmisimi i kushteve të punës për Inspektor - Furnizim me pajisje të punës Laptop dhe Tablet;
- Sigurimi i Buxhetit nga bartja e të hyrave Vetanake për inicimin e procedurave të Kontratës për Rrënim;
- Inicim/kërkesë dhe bashkëpjesëmarrje në plotësim ndryshimin e rregulloreve komunale;
- Organizim i aksioneve për lirimin e hapësirave publike duke u nisur nga objektet, lokalet, terasat, kiosqet, mureve e deri të lirimi i trotuareve dhe parkingjeve qofshin ato të uzurpuara apo ato që shfrytëzoheshin jashtë ligjshëm.
- Organizim i Aksioneve të Bash inspektimit me Inspektoret Sanitar për mos respektim të ligjit për ndalimin e duhanit në hapësirat ku ndalohet konsumimi i tij;
- Bash Inspektim me Inspektoratin e Ndërtimit;
- Koordinim i aktiviteteve së bashku me agjencinë e pyjeve në lidhje me shitësit Ambulant në tregun e Mitrovicës;
- Inicim i procedurave për pagesën e kostove të rrënitimit sipas Ligjit të Procedurës së Përgjithshme Administrative;
- Monitorim i Inspektorëve për gjatë Inspektimeve në të gjithë Sektorët;

Raporti i punës së Drejtorisë e Inspekcionit, paraqet përmbledhje të punëve, aktiviteteve dhe veprimeve të ndërmarra në zbatim të dispozitave relevante ligjore dhe nënligjore, Planit të Punës dhe në trajtim të kërkesave të parashtruara institucionit tonë dhe rasteve ad-hoc të paraqitura. Në ushtrimin e funksionit, bazuar në kompetencat dhe përgjegjësit juridike, Drejtoria e Inspekcionit konsideron se ka përmbushur planin vjetor të punës për periudhën Janar-Qershor 2026 madje edhe duke i kaluar pritshmërit për këtë gjashtëmujorë të këtij viti.

Këto veprime por edhe veprimet tjera të ndërmarra me veprime konkrete, po i paraqesim në formë tabelore të detajuara në të gjithë sektorët, duke u nisur nga ato të filluara, në procese dhe të përfunduara.

SEKTORI I NDËRTIMIT:

	Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo Komuna e Mitrovicës Opstina Mitrovica – Municipality of Mitrovica Drejtoria e Inspeksionit	
---	---	---

REFERENCE	Drejtoria e Inspeksionit
PËR /ZA/TO	z. Mujë Igrishta - Drejtor i Drejtorisë së Inspeksionit
CC:	//
PËRMES/PREKO/THROUGH:	znj. Leonida Sherifi -Zyrtare Administrative
NGA/OD/FROM:	z. Vehbi Ahmeti - Sektori i ndërtimit
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Raporti gjashtëmuor
DATA/DATUM/DATE:	05.01.2026 – 30.06.2026

AKTIVITET <i>Janar – Qeshor, 2026</i>	II
Vizita dhe kontakte pune	397
Inspektime ne teren	390
Inspektimet me procesverbal	182
Me shtojcat 1,2,3,4/a, 4/b,4/c, 4/d ,4/e ,4/f UA. MMPH -Nr. 05/2017	208
Aktvendime për ndërprerjen të ndërtimit	31
Aktvendime për rrënim	26
Konzervimet e objekteve të ndërtimit	27
Gjobat Mandatore në bazë të U.A. MMPH –Nr.20/2013 vlera 6600.00 €	17
Kërkesë për gjykatë	10
Kallëzime penale	13
Objektet banesore, afariste	14
Objektet banesore individuale	19
Objektet kolektive	36
Lejet për ndërtim nga DPU	11
Lejet për pëlqim nga DSHPI	10
Ankesat të palëve	15
Kërkesë të palëve	42
Lëndë ne procedurë	115
Lëndë të përmbaara	156
Totali i lëndëve	271

SEKTORI I TREGUT;

	Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo Komuna e Mitrovicës Opstina Mitrovica – Municipality of Mitrovica Drejtoria e Inspeksionit	
---	---	---

REFERENCE	Drejtoria e Inspeksionit
PËR /ZA/TO	z. Mujë Igrishta - Drejtor i Drejtorisë së Inspeksionit
CC:	//
PËRMES/PREKO/THROUGH:	znj. Leonida Sherifi -Zyrtare Administrative
NGA/OD/FROM:	z. Blerim Hyseni – Shef i Sektorit
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Raporti Janar – Shkurt
DATA/DATUM/DATE:	Janar – Shkurt 2026

AKTIVITET	Nr.
Inspektive ne teren	29
Aktvendime mbi evitimn e parreguullsive	9
Aktvendime mbi shqiptimin e gjobave	4
Gjithësejt Aktvendime	13
Mbylljen e lokalit	1
Gjoba	4
Vlera e Gjobave	4300 €
Vlera te pagesave te gjobave ne €	1150 €
Ankesa e konsumatorit	4
Asgjësimit i mallit	/
Vlera e asgjësimit te mallit ne €	/
Kërkesa për Gjykatë	/
Aktivite te tjera „ paisje me pelqim	7
Mjete te inkasuara nga Pelqimi	999.50
Lëndë ne procedurë	9
Lëndë të përmbaruara	20
Totali i lëndëve	29

SEKTORI I SHËRBIMEVE PUBLIKE;

	Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo	
	Komuna e Mitrovicës Opstina Mitrovica – Municipality of Mitrovica	
Drejtoria e Inspeksionit, Sektori për ShPMM		
PËR/ZA/TO:	Mujë Igrishta , Drejtor i Drejtorisë së Inspeksionit	
CC:	Leonida Sherifi , Asistente administrative	
PËRMES/PREKO/THROUGH:	//	
NGA/OD/FROM:	Fatmir Kelmendi , Udhëheqës i Sektorit të Shërbimeve Publike dhe Mbrojtje të Mjedisit	
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Raport (6) gjashtë mujor	
DATA/DATUM/DATE:		

AKTIVITET	Nr.
Inspektime ne teren me Procesverbal Kadri Avdiu	83
Inspektime ne teren me Procesverbal Agron Sylejmani	88
Inspektime ne teren me Procesverbal Shenasi Uka	80
Inspektime ne teren me Procesverbal Nexhat Murati	12
Inspektime ne teren me Procesverbal Kimete Berisha	230
Gjithsejtë Procesverbale te Sektorit	493
Aktvendime mbi evitimin e parregullsive Kadri Avdiu	6
Aktvendime mbi evitimin e parregullsive Agron Sylejmani	1
Aktvendime mbi evitimin e parregullsive Shenasi Uka	6
Aktvendime mbi evitimin e parregullsive Nexhat Murati	
Aktvendime mbi evitimin e parregullsive Kimete Berisha	28
Gjithsejtë Aktvendime te sektorit	41
Kërkesa të qytetarëve Kadri Avdiu	8
Kërkesa të qytetarëve Agron Sylejmani	7
Kërkesa të qytetarëve Shenasi Uka	5
Kërkesa të qytetarëve Nexhat Murati	7
Kërkesa të qytetarëve Kimete Berisha	12
Gjithsejtë kërkesa të qytetarëve	39
Gjoba mandatore Kadri Avdiu	2
Gjoba mandatore Agron Sylejmani	1
Gjoba mandatore Shenasi Uka	1
Gjoba mandatore Kimete Berisha	14
Gjithsejtë gjoba mandatore	18

SEKTORI PËR TRANSPORTIN RRUGOR:



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Mitrovicës
Opstina Mitrovica – Municipality of Mitrovica



Drejtoria e Inspeksionit, Sektori për Transportin Rrugor

PËR/ZA/TO:	Mujë Igrishta Drejtor i Drejtorisë së Inspeksionit
CC:	
PËRMES/PREKO/THROUGH:	
NGA/OD/FROM:	Ilir Ahmeti, Artan Ibishi – Sektori i Transportit Rrugor
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Raport
DATA/DATUM/DATE:	05.01.2026 - 26.06.2026

AKTIVITET	Nr.
Inspektime në teren me raport për transport	92
Inspektime në teren me raport për parkingje publike	22
Inspektime në teren me Procesverbal	47
Asistime brenda drejtorisë	64
Bashkë-inspektim	38
Aktvendim – Pëlqim/Inkasim	11=170 €
Kërkesa	15
Kërkesa për Gjykatë	/
Gjobë mandatore	15
Gjithsej vlera e gjobave	2900 €
Totali i aktiviteteve inspektuese	208

SEKTORI PËR MBROJTJE TË MJEDISIT;



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Mitrovicës
Opstina Mitrovica – Municipality of Mitrovica

Drejtoria e Inspeksionit

REFERENCË	Drejtoria e Inspeksionit
PËR/ZA/TO:	Muje Igrishta, Drejtor i Drejtorisë së Inspeksionit
CC:	
PËRMES/PREKO/THROUGH:	
NGA/OD/FROM:	Mirvete Bajraktari Uka Inspektore e Mjedisit
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Raporti 2 - Mujor
DATA/DATUM/DATE:	27.04.2026 - 26.06.2026

AKTIVITET	Nr.
Vizita dhe kontakte pune	46
Inspektime me procesverbal	26
Aktivitete te tjera dhe lëndë të mbyllura në zyre	\
Aktvendime për marrjen e pëlqimit për TAXI	/
Përfundimet nga qarkullimi i komunikacionit rrugor	/
Kërkesa për Gjykatë	/
Ankesa e konsumatorit	/
Inspektim me Raport	\
Lëndë ne procedurë	
Lëndë të përmbaruara	\
Totali i lëndëve	\

RAPORTI NGA ZYRA LIGJORE DHE ADMINISTRATA E DREJTORISË;

Raporti Ditor i Punës për muajin Janar – Qershor 2026			
Nr.	Data	Lënda	<i>Akti-veprimi</i> <i>Rekomandime;</i> <i>Aktvendime;</i> <i>Vendime;</i> <i>Mbajtje e Procesverbalëve;</i> <i>Udhëzime;</i> <i>Parashtresa;</i> <i>Shqyrtim i Ankesave;</i> <i>Përgaditja e Dosjeve;</i> <i>Porositja e Materialit për Zyre;</i>

Sqarim: Ky raport pasqyron aktivitetet dhe punën kryesore të zyrtarit ligjor dhe asistentes administrative në Drejtorinë e Inspektionit. Puna e të dy zyrtarëve kryesisht përbëhet nga ofrimi i shërbimeve administrative, këshillave dhe udhëzimeve ligjore për kolegët dhe drejtorinë e drejtorisë, të cilat shpesh për nga numri i tyre në baza ditore arrin numër dyshifror.

1. STATISTIKAT

Më poshtë janë paraqitur në mënyrë tabelare aktivitetet, masat dhe veprimet që janë ndërmarr gjatë punës së Drejtorisë së Inspektionit për periudhën Janar-Qershor 2026, të përmbledhura në të dhëna numerike.

<i>AKTIVITET</i>	Nr.
Gjithsejtë Procesverbale	985
Gjithsejtë Aktvendime	137
Gjithsejtë kërkesa/ankesa të qytetarëve	115
Gjithsejtë gjoba mandatore	54

PËRFUNDIM

Raporti i Punës i Drejtorisë së Inspektionit për periudhën Janar-Qershor 2026 është dokument i rëndësishë së veçantë ngase ofron informacione të rëndësishme mbi punën, aktivitetin dhe angazhimin e kësaj drejtorie në zbatim të ligjit, mbajtje të rendit komunal dhe realizim të planit vjetor të punës. Në kuadër të ushtrimit të mandatit ligjor, Drejtoria e Inspektionit ka hasur në një vargë vështirësish dhe probleme si ato të natyrës njerëzore po ashtu edhe teknike, të cilat janë tejkaluar me suksesë, falë profesionalizimit dhe vullnetit të lartë të treguar nga menaxhmenti dhe stafi profesional i kësaj drejtorie.

REKOMANDIMET PËR PERIUDHËN QERSHOR – DHJETOR 2026

Shkalla e cilësisë	E kënaqshme	E mirë	Shumë e mirë	✓ Mund të përmirësohet
	➤ <i>Kompletim i Legjislacionit (plotësim ndryshim i rregulloreve);</i> ➤ <i>Të Vazhdohet me Aktivitete dhe ritëm të shpjeg në evidentimin e të gjitha ndërtimeve pa leje;</i> ➤ <i>Lirimin e hapësirave publike të Uzurpuara;</i> ➤ <i>Lirimin e pronave, objekteve dhe lokaleve pa leje;</i> ➤ <i>Largimin e anekseve që shfrytëzohen pa i kryer obligimet Kontraktuale ndaj Komunës;</i> ➤ <i>Të urdhërohen bizneset të aplikojnë për marrjen e pëlqimi/lejes për shfrytëzimin e hapësirave – terasave;</i> ➤ <i>Vazhdimësi e Aktiviteteve për largimin e Shitësve Ambulantiv;</i> ➤ <i>Të obligohen të gjithë taksit ilegal të pajisen me leje dhe licencë;</i> ➤ <i>E njëjta të veprohet edhe me sektorët tjerë nga Transporti Rrugor, Urban dhe Ndërrurban dhe e njëjta edhe me Radiotaksit;</i> ➤ <i>Ndërrim i destinacionit të Parkingjeve për Radiotaksit në qytet;</i> ➤ <i>Vazhdim i Aktivitetit – Bashkë inspektim për respektimin e Ligjit që ndalon Pirjen e Duhanit;</i> ➤ <i>Bashkinspektim me Inspektoratin e Punës për shkëlqen e të drejtave të punëtorëve në Sektorin Privat brenda Komunës së Mitrovicës;</i> ➤ <i>Bashkinspektim me Veterinar në çështjet e tregut (prerja e pulave dhe zogjve);</i> ➤ <i>Bashkinspektim me Inspektor e agjencionit të Pyjeve për shitësit ambulantiv të druve;</i> ➤ <i>Bashkinspektim me Inspektor të Ministrisë së Ambientit dhe Planifikimit Hapësinor;</i> ➤ <i>Bashkinspektim me Inspektoret Komunal të Komunave të Regjionit sipas kërkesave të paraqitura;</i> ➤ <i>Bashkinspektim me Inspektorët e Trashëgimisë Kulturore në Kuadër të Ministrisë së Kulturës Rinis dhe Sportit;</i> ➤ <i>Bashkëpunim me Stacionin Policor të Mitrovicës së Jugut(sipas kërkesës);</i> ➤ <i>Bashkëpunim me Prokurorinë e Kosovës (sipas nevojës);</i> ➤ <i>Bashkëpunim me Krimet Ekonomike(sipas kërkesës);</i> ➤ <i>Bashkëpunim me Krimet e Rënda (sipas kërkesës);</i> ➤ <i>Si dhe të tjera varësisht nga kërkesat që parashtrihen nga palët - Qytetarët.</i>			
Masat që duhet Ndërmarrë;	➤ <i>Nga Drejtoria e Financave, mos të ketë vonesa në realizimin/ekzekutimin e pagesave sipas obligimeve Kontraktuale;</i> ➤ <i>Mese urgjente intervenimi në infrastrukturën e punës – pajisja me vetura zyrtare të punës;</i> ➤ <i>Organizimi i Trajnimeve për të gjithë Inspektorët e Drejtorisë.</i>			
Vlerësimi i Progresit për këtë periudhë;	<i>Dinamikë e kënaqshme dhe e Suksesshme e Aktiviteteve.</i>			